



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr.38, datë 26.06.2007

**“PËR KALIMIN KAPITAL TË ZYRAVE TË UZINËS MEKANIKE “TIRANA”
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE DHE
MIRATIMIN E PROJEKTIT TË RIKONSTRUKSIONIT TË KËSAJ GODINE”**

Në mbështetje të Ligjit Nr.8652, datë 31.07.2000, “ Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 8 , pika II, gërma “a”, gërma “c”, gërma “d”, V. K. M. Nr.153 datë 03.04.1999 ”Për kalimin e objekteve të mjeteve kryesore të ndërmarrjeve dhe institucioneve shtetërore ”, pika 2, gërma “ç”, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.23, datë 30.04.2007 “Për realizimin e Buxhetit të vitit 2006 dhe miratimin e Buxhetit të vitit 2007 të Bashkisë së Tiranës”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Kalimin kapital të Zyrave të Uzinës Mekanike “Tirana “ nga Uzina Mekanike “Tirana” sipas Genplaneve bashkëngjitur si më poshtë:

Pjesa Ballore e Repartit Mekanik dhe konstruksion 1454 m²

- Kati i parë 524.5 m²
- Kati përdhe 714.5 m²
- Bodrumi 215 m²

Zyra e Byrosë Teknologjike 491 m²

- Truall funksional 3.146.5 m²

në administrim të Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore, me emërtesen “**Zyra të Administratës së Taksave dhe Tarifave Vendore**”, si më poshtë:

1.1 Ndërtesa 2 katëshe e Administratës

Sipërfaqja e objektit gjithsej (kati I + kati II + bodrum) 1.945 m²

1.2 Truall funksional

3.146.5 m²

2. Në zbatim të pikës 1 të këtij Vendimi, të kryhen veprimet kontabël për transferimin e objekteve nga Uzina Mekanike “Tirana” dhe Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe

Tarifave Vendore ne bilancet e tyre kontabel, sipas akteve ligjore në fuqi, brenda muajit Shtator të vitit 2007.

3. Ngarkohet Uzina Mekanike "Tirana" dhe Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, që në bashkëpunim me Drejtorinë e Urbanistikës në Bashkinë e Tiranës të hartojnë gen-planet, për objektet qe do të mbeten në administrimin e tyre.

4. Trualli nën ndërtesën e Zyrave të Administratës së Uzinës Mekanike në katin e parë prej 112.5 m² do të jetë truall i përbashkët për Uzinën Mekanike dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore.

5. Efektet financiare për objektin "Rikonstruksion i zyrave të administratës së Taksave dhe Tarifave Vendore (faza e 1-rë), të mbulohen nga fondet e miratuara për investime në objektin "Rikonstruksion Asete (Policia Bashkiake, Taksa), miratuar në Buxhetin e vitit 2007.

6. Shuma prej 23.000.000 lekësh, të përdoret si më poshtë:

- Ndërtim montim	22.500.000 lekë
- Mbikqyrje punimesh	470.000 lekë
- Kolaudim	30.000 lekë

7. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, Uzina Mekanike "Tirana", Drejtoria e Përgjithshme e Urbanistikës, Drejtoria e Prokurimit Publik.

6. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SOKOL DERVISHAJ

K R Y E T A R